
INVESTITORI
“DP & PARTNERS” SH.P.K.
Qylagë, Komuna Lipjan



RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR FABRIKËN E PRODHIMIT
TË GËLQERËS, LLAÇEVE, NGJYRAVE DHE MATERIALEVE IZOLUESE
“DP & PARTNERS”SH.P.K. QYLAGË, KOMUNA E LIPJANIT

Janar – 2025

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR FABRIKËN E PRODHIMIT TË
GËLQERËS, LLAÇEVE, NGJYRAVE DHE MATERIALEVE IZOLUESE
“DP & PARTNERS”SH.P.K. QYLAGË, KOMUNA E LIPJANIT

Ngastra me nr. 00476-6, 00476-7 dhe 00476-8, Zona kadastrale Qylagë, Komuna Lipjan

	Emri I Investitorit
Aplikuesi	Durim Prishtina, Bashkë Pronar, Person i Autorizuar
Investitori:	“DP & PARTNERS” SH.P.K. Pronarët: Negjat Halili, Liridon Berisha, Yllka Prishtina, Abedin Beqiri
Adresa:	Rruga Enver Maloku, Kompleksi Tregtia Lokal Pn
Lokacioni i Fabrikës	Qylagë, Komuna Lipjan
Tel:	+383 44 804 805
Email:	durimp@gmail.com

Investitori:

“DP & PARTNERS” SH.P.K.

Emri i Hartuesit të Raportit të VNM-së

Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari

Nënshkrimi

Nënshkrimi

Blerinabajraktari1@gmail.com

+383 49 588 634

Janar 2025

PËRMBAJTJA:

1.	HYRJE	1
2.	KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së	2
3.	PËR KOMPANINË.....	3
	a) Vendndodhja e Fabrikës	4
	b) Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit	5
	c) Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit.....	7
	d) Përshkrimi detal i procesit teknologjik	9
	e) Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjate fazës së operimit.....	13
4.	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME.....	14
5.	GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT	15
	5.1 Hidrografia.....	15
	5.2 Ndotësit Kryesorë	16
	5.3 Flora dhe Fauna.....	17
	5.4 Transporti dhe infrastruktura	18
	5.5 Mbeturinat e ngurta.....	19
6.	IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS	20
	6.1 Ndikimet në ajër.....	20
	6.2 Ndikimet në tokë.....	21
	6.3 Ndikimet ne ujë.....	21
	6.4 Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë	22
	6.5 Ndikimet në vendbanime dhe popullatë	22
	6.6 Ndikimet nga zhurma.....	22
	6.7 Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore.....	23
	6.8 Ndikimi mjedisor nga mbeturinat	23
	6.9 Trashëgimia Kulturore	24
7.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS	25

8.	PËRSHKRIMI I METODAVE PËR VLERËSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE	26
9.	PËRSHKRIMI I MASAVE.....	27
9.1	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër	28
9.2	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë.	29
9.3	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë	30
9.4	Masat për mbrojtje nga zhurma	31
9.5	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë.....	31
9.6	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë	32
9.7	Masat për menaxhimin e mbeturinave	32
9.8	Masat rehabilituese	33
9.1	Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve	34
10.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE	35
11.	MONITORIMI DHE RAPORTIMI.....	36
12.	PËRFUNDIM	37
13.	FORMA TABELARE E KOSTOS INVESTIVE	38
14.	LITERATURA E PERDORUR	39

Lista e Figurave

Figura 1.	Shtirirja hapësinore e Lokacionit të Kompanisë.....	4
Figura 2.	Distanca e kompanisë me qytetin e Lipjanit.....	4
Figura 3.	Distanca e Fabrikës nga Shtëpi Banimi.....	5
Figura 4.	Plani i organizimit të objekteve	6
Figura 5.	Makina për prodhimin e ngjyrave	12
Figura 6.	Scema e Procesit teknologjik.....	13
Figura 7.	Harta Hidrogeologjike.....	16
Figura 8.	Harta e mjedisit pyjor	18
Figura 9.	Infrastruktura rrugore	19

Lista e Tabelave:

Tabela 1	Tabela e mbeturinave sipas katalogut shtetëror.....	33
----------	---	----

1. HYRJE

Kompania "DP Partners" Sh.p.k. ka planifikuar ndërtimin e një fabrike moderne për prodhimin e gëlqeres, llaçëve, ngjyrave dhe materialeve izoluese në fshatin Qylag, Komuna e Lipjanit, Kosovë. Ky projekt synon të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të zonës duke siguruar produkte cilësore për industrinë e ndërtimit.

Për të siguruar që projekti të jetë në përputhje me standardet mjedisore dhe për të minimizuar ndikimet negative në mjedis dhe komunitet, kompania ka vendosur të hartojë një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis. Ky raport do të analizojë në detaje të gjitha aspektet e projektit, duke përfshirë proceset teknologjike, përdorimin e burimeve natyrore dhe masat për menaxhimin e mbetjeve, me qëllim promovimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm ndaj mjedisit.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është një dokument thelbësor dhe i domosdoshëm për marrjen e Pëlqimit Mjedisor nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Ky raport do të identifikojë dhe analizojë ndikimet potenciale mjedisore të projektit, si dhe do të propozojë masa për minimizimin e tyre. Pas plotësimit të kushteve të përcaktuara nga Pëlqimi Mjedisor, investitori duhet të vazhdojë me aplikimin për lejet e tjera të nevojshme për operimin e fabrikës.

Ky vlerësim i ndikimit në mjedis për kompaninë “**DP & PARTNERS**” SH.P.K, me lokacion në Qylagë të Komunës së Lipjanit, është punuar duke u bazuar në projektin e projektuar për ndërtim, gjendjen aktuale të lokacionit, karakteristikat e lokacionit, gjendjen ekzistuese të mjedisit rreth lokacionit të fabrikës së kompanisë “**DP - PARTNERS**” SH.P.K. si dhe dokumentit teknik ekzistues. Detyra e përgatitjes së këtij raporti të VNM-së fabrikës për prodhimin e gëlqeres, llaçnave, ngjyrave dhe materialeve izoluese, kryesisht ka për qëllim identifikimin e burimeve të ndotjes, vlerësimin e ndikimit të tyre në mjedis si dhe propozimin e veprimeve për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis deri në kufijtë e lejuar. Të gjitha konstatimet dhe rekomandimet për mbrojtjen e mjedisit që dalin nga ky raport, duhet të merren për bazë, gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit të fabrikës.

2. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së

Bazuar në karakteristikat e fabrikës për prodhimin e gëlqeres, llaçnave, ngjyrave dhe materialeve izoluese me të gjithë infrastrukturën përcjellëse dhe sipas projektit të përfunduar, ku ky projekt është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis. **Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis** i cili është baza kryesore ligjore të cilit ju kemi referuar. Shtojca 1 dhe 4 e këtij ligji.

Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar edhe ligje të tjera relevante, si:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060,
- Ligji nr. 08/l-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/l-060 për mbeturina
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për Mbrojtje nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për Mbrojtje nga Zjarri Nr. 08/L-261
- Ligji për Ndërtim Nr. 04/ L-110
- Ligji për Planifikim Hapësinor Nr.03/L-106

Udhëzimet administrative:

- UA (MMPHI) nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor,
- Udhëzim Administrativ nr. 13/2013 për katalogun shtetëror të mbeturinave.

Pasi që për këtë veprimtari përdoren disa materiale si hynë tek kategoritë më të rrezikshme atëherë është e nevojshme të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM), atëherë për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore, investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikon për pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë (MMPHI).

3. PËR KOMPANINË

Sllogani i kompanisë "DP & Partners" – “Një emër që ju i besoni” – përmbledh qartë dhe saktë vlerat e kompanisë, duke reflektuar përkushtimin e saj ndaj klientëve dhe angazhimin për të ofruar shërbime cilësore. Ky sllogan, i cili e ka shoqëruar kompaninë për gati katër vite, thekson rëndësinë që kompania i kushton ndërtimit të marrëdhënieve të qëndrueshme dhe të besueshme me klientët e saj.

DP & Partners është një emër i ri dhe premtues në industrinë e ndërtimit, i themeluar mbi një koncept bashkëkohor dhe inovativ. Kompania mbështetet në një ekip ekspertësh me përvojë të gjatë dhe të thelluar në sektorin e ndërtimit. Në krye të këtij grupi profesional qëndron z. Durim Prishtina, një emër i njohur në fushën e ndërtimit me mbi 20 vite përvojë. Udhëheqja e tij vizionare ka luajtur një rol kyç në ndërtimin e reputacionit të kompanisë si një ofrues shërbimesh të besueshme dhe me cilësi të lartë.

Të gjitha projektet e realizuara nga DP & Partners ndodhen në zona të urbanizuara dhe përmbushin të gjitha kërkesat e lejeve dhe standardeve të ndërtimit. Procesi i projektimit dhe ekzekutimit mbikëqyret nga një grup profesional arkitektësh, inxhinierësh dhe menaxherësh me përvojë. Ky ekip i specializuar trajton me kujdes të gjitha fazat e projekteve, duke u siguruar që secili detaj, sado i vogël, të jetë i përmbushur me përpikëri. Përdorimi i teknologjive moderne dhe qasja gjithëpërfshirëse ndaj ndërtimit sigurojnë që projektet e DP & Partners të jenë jo vetëm estetikisht të kënaqshme, por edhe funksionale, të qëndrueshme dhe në përputhje me kërkesat e kohës. Kjo qasje e përkushtuar ndaj detajeve dhe profesionalizmit është një ndër faktorët kryesorë që garanton suksesin e kompanisë, jo vetëm në të tashmen, por edhe për të ardhmen. Kjo kompani ka te punësuar mbi 3500 punëtorë, ka 9 fusha veprimi dhe 5 lokacione te ndryshme ne te cilat operon.

DP & Partners vendos në qendër të vizionit të saj vlerat e klientëve, duke krijuar një marrëdhënie të bazuar në besim, profesionalizëm dhe respekt. Përmes realizimit të projekteve që përmbushin standardet më të larta mjedisore dhe ndërtimore, kompania dëshmon angazhimin e saj për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve dhe industrisë së ndërtimit.

Me një fokus të qartë në cilësi, përpikëri dhe inovacion, DP & Partners vazhdon të ndërtojë një trashëgimi të besimit dhe suksesit në industrinë e ndërtimit.

a) Vendndodhja e Fabrikës

Objekti i planifikuar për ndërtimin e fabrikës për prodhimin e gëlqeres, llaçeve, ngjyrave dhe materialeve izoluese do të ndërtohet në zonën kadastrale Qylagë, Komuna e Lipjanit. Ndërtimi do të realizohet në ngastrat kadastrale me numra përkatës 00476-6, 00476-7 dhe 00476-8. Ky pozicion gjeografik është zgjedhur duke marrë parasysh urbanizimin e zonës dhe përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe planifikimin hapësinor për zhvillimin industrial.




Figura 1. Shtrirja hapësinore e Lokacionit të Kompanisë




Figura 2. Distanca e kompanisë me qytetin e Lipjanit

Në afërsi të fabrikës për prodhimin e gëlqeres, llaçeve, ngjyrave dhe materialeve izoluese, e cila është e vendosur në Zonën Kadastrale Qylagë të komunës së Lipjanit, dhe të gjitha objektet e fabrikës janë të orientuara për aktivitete industriale. Fabrika operon në një mjedis industrial,

ku zhvillohen procese prodhimi të ndryshme të materialeve të përmendura. Po ashtu, distanca më e afërt mes fabrikës dhe zonës rezidenciale (shtëpive) është mbi 800 metra, duke siguruar një shkëputje të konsiderueshme ndërmjet aktiviteteve industriale dhe zonës rezidenciale, gjë që mund të kontribuoni në zvogëlimin e ndikimeve të mundshme nga proceset industriale në banorët e zonës.



Figura 3. Distanca e Fabrikës nga Shtëpi Banimi

b) Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit

Fabrika për prodhimin e gëlqeres, llaçeve, ngjyrave dhe materialeve izoluese është e vendosur në Zonën Kadastrale Qylagë të komunës së Lipjanit. Ky kompleks industrial përbëhet nga shtatë objekte të ndryshme, të cilat janë të shpërndara brenda kompleksit dhe janë të organizuara në mënyrë funksionale për realizimin e proceseve prodhuese. Këto objekte janë të dizajnuara për të mbështetur efikasitetin e procesit prodhues dhe për të siguruar cilësinë e lëndëve të para dhe produkteve të përfunduara.

Objektet që përbëjnë kompleksin janë si më poshtë:

1. Objekti administrativ, me etazhitet "P+1", që shërben për menaxhimin dhe koordinimin e aktiviteteve të fabrikës, duke mbikëqyrur operacionet dhe menaxhimin e proceseve të përditshme.

2. Objekti i parë, i cili është dedikuar për magazinimin e lëndës së parë, ku materialet e nevojshme për prodhim ruhen dhe organizohen për t’u përdorur në fazat e mëvonshme të procesit prodhues.
3. Objekti i dytë, që është përgjegjës për përpunimin e lëndës së parë, me etazhitet "P+0". Ky objekt ka për qëllim kalimin e lëndëve të para në proceset e përpunimit për të krijuar materialet e nevojshme për prodhimin e ngjyrave, llaçeve dhe produkteve të tjera.
4. Objekti i tretë, që përmban fazën finale të prodhimit dhe përpunimit final, gjithashtu me etazhitet "P+0". Ky objekt është përgjegjës për përfundimin e procesit prodhues dhe përgatitjen e produkteve për shpërndarje.
5. Objekti i katërt, që shërben si depo për ruajtjen e materialeve të prodhuara, gjithashtu me etazhitet "P+0". Ky objekt siguron hapësirën për ruajtjen dhe mbrojtjen e produkteve të përfunduara para se ato të shpërndahen për konsum.
6. Dy objekte të tjera, të dedikuara për funksionimin e furrës së gëlqeres dhe procesit të hidratimit, gjithashtu me etazhitet "P+0". Këto objekte mbështesin proceset specifike të prodhimit, duke përfshirë furrat dhe teknologjitë e përdorura për përpunimin e materialeve të nevojshme.




Figura 4. Plani i organizimit të objekteve

c) Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit

Faza operative e projektit për fabrikën e prodhimit të gëlqeres, llaçeve, ngjyrave dhe materialeve izoluese përfshin disa veçori kryesore që lidhen me proceset teknologjike, menaxhimin e burimeve dhe masat për mbrojtjen e mjedisit. Këto veçori janë si më poshtë:

1. Proceset Teknologjike dhe Prodhimi

Operacionet e fabrikës do të përfshijnë përgatitjen e lëndëve të para, përpunimin dhe prodhimin e materialeve të ndërtimit sipas standardeve bashkëkohore. Lëndët e para që do të përdoren në prodhim janë:

Gëlqerorët (guri gëlqeror): Burimi kryesor për prodhimin e gëlqeres, i cili përpunohet përmes proceseve të plota të kalcinimit dhe bluarjes.

Argjila dhe rëra kuarci: Elementë thelbësorë për prodhimin e llaçeve dhe materialeve ndërtimore, të cilat sigurojnë qëndrueshmëri dhe forcë strukturore.

Pigmentet natyrore dhe sintetike: Të përdorura për prodhimin e ngjyrave, këto pigmente sigurojnë një gamë të gjerë ngjyrash me qëndrueshmëri të lartë ndaj kushteve të jashtme.

Materialet lidhëse hidraulike: Si p.sh., çimentoja dhe komponimet kimike që ndihmojnë në përmirësimin e vetive të llaçeve dhe materialeve ndërtimore.

Aditivët : Përfshijnë aditivët për kontrollin e tharjes, përmirësimin e elasticitetit dhe qëndrueshmërisë së produkteve.

Uji: Një komponent i domosdoshëm për përzierjen dhe përgatitjen e produkteve ndërtimore.

Të gjitha lëndët e para do të përzgjidhen dhe përdoren në përputhje me standardet ndërkombëtare për cilësi dhe siguri, duke siguruar gjithashtu që burimi i tyre të jetë i qëndrueshëm dhe të minimizohen ndikimet mjedisore gjatë procesit të prodhimit.

Kompania planifikon të sigurojë furnizimin e lëndëve të para për fabrikën për prodhimin e gëlqeres, llaçeve, ngjyrave dhe materialeve izoluese përmes bashkëpunimit me kompani të ndryshme të specializuara në këtë fushë. Lëndët e para, si guri gëlqeror, argjila, rëra, pigmentet dhe materialet lidhëse, do të furnizohen nga partnerë të besuar, me të cilët kompania do të arrijë marrëveshje afatgjata dhe të qëndrueshme.

Këto marrëveshje do të sigurojnë furnizim të vazhdueshëm dhe cilësi të garantuar të lëndëve të para, duke marrë parasysh kërkesat teknike dhe standardet ndërkombëtare. Për më tepër, kompania do të vlerësojë me kujdes burimet e furnitorëve për të siguruar që ato janë të përputhshme me politikën për mbrojtjen e mjedisit dhe qëndrueshmërisë.

Kjo qasje jo vetëm që garanton efikasitetin e operacioneve të fabrikës, por gjithashtu mbështet ndërtimin e marrëdhënieve të forta me industrinë vendore dhe ndërkombëtare, duke kontribuar në një zinxhir furnizimi të qëndrueshëm dhe konkurrues.

Lëndët ndihmëse luajnë një rol thelbësor në përmirësimin e cilësisë, qëndrueshmërisë dhe performancës së produkteve të prodhuara në fabrikë. Në këtë kontekst, fabrikat për prodhimin e gëlqeres, llaçeve, ngjyrave dhe materialeve izoluese përdorin një gamë të gjerë lëndësh ndihmëse, të cilat përfshijnë:

Aditivët kimikë: Këto substanca përdoren për të rritur elasticitetin, përshkueshmërinë dhe kohën e tharjes së llaçeve dhe materialeve të ndërtimit.

Plastifikuesit: Këta komponime ndihmojnë në përmirësimin e punueshmërisë së materialeve ndërtimore, duke i bërë ato më të lehta për t’u aplikuar.

Stabilizuesit dhe përforcuesit: Përfshijnë substanca që rrisin forcën mekanike dhe stabilitetin e produkteve përfundimtare.

Rezina dhe polimere: Këto përdoren veçanërisht në ngjyrat dhe materialet izoluese për të siguruar qëndrueshmëri dhe rezistencë ndaj kushteve të jashtme.

Pigmente ndihmëse: Përdoren për të rritur uniformitetin dhe intensitetin e ngjyrave.

Agjentët për reduktimin e pluhurit: Këta kimikate ndihmojnë në minimizimin e krijimit të pluhurit gjatë procesit të prodhimit dhe aplikimit të materialeve.

Antifungale dhe antimikrobike: Përbërës që përdoren për të parandaluar rritjen e mykut dhe mikroorganizmave në produktet përfundimtare.

Agjentët kundër ngricës: Këto substanca ndihmojnë në mbrojtjen e produkteve nga dëmtimi gjatë ekspozimit në temperatura të ulëta.

Shkumëzues dhe antishkumëzues: Përdoren për kontrollimin e shkumës gjatë përzierjes së materialeve, dhe

Energjia elektrike.

Lëndët ndihmëse përzgjidhen me kujdes për të siguruar që ato të jenë të përputhshme me standardet mjedisore dhe të mos shkaktojnë ndikime negative gjatë prodhimit apo përdorimit të produkteve përfundimtare. Këto përbërës janë thelbësorë për rritjen e cilësisë së përgjithshme dhe qëndrueshmërisë së produkteve të fabrikuara.

Teknologjitë e përdorura janë të avancuara, me qëllim minimizimin e humbjeve dhe rritjen e efikasitetit të prodhimit.

2. Kapaciteti Prodhues

- Fabrika është projektuar për të përmbushur kërkesat e tregut me kapacitete prodhuese të larta dhe një gamë të gjerë produktesh të ndërtimit.

Sasia e prodhimit të gëlqeres, llaçeve, ngjyrave dhe materialeve izoluese do të jetë: $2 \times 35 \text{m}^3/\text{h}$.

- Do të ketë një menaxhim të mirë të zinxhirit të furnizimit dhe të shpërndarjes së produkteve.

3. Menaxhimi i Energjisë dhe Burimeve

- Energjia e përdorur do të jetë në përputhje me normat e efikasitetit energjetik, duke përfshirë përdorimin e burimeve të rinovueshme kur të jetë e mundur.
- Lëndët e para do të përpunohen me kujdes për të minimizuar mbetjet dhe për të maksimizuar përdorimin e tyre.

4. Mbrojtja e Mjedisit dhe Masat për Zvogëlimin e Ndikimeve

- Në fazën operative do të implementohen masa për zvogëlimin e ndotjes së ajrit, tokës dhe ujit përmes sistemeve të filtrimit dhe riciklimit.
- Mbetjet e prodhimit do të trajtohen në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme, në përputhje me standardet mjedisore.

5. Krijimi i Vendeve të Punës

Aktivitetet operacionale të fabrikës do të kontribuojnë në punësimin lokal, duke krijuar vende pune për profesionistë të ndryshëm, përfshirë inxhinierë, teknikë dhe staf administrativ.

6. Infrastrukturë dhe Logjistikë

- Fabrika do të integrohet me rrjetin e infrastrukturës lokale, duke përfshirë rrugët e transportit për furnizim dhe shpërndarje të produkteve.
- Logjistika do të organizohet për të siguruar një zinxhir furnizimi të qëndrueshëm dhe të besueshëm.

Kjo fazë operative përfaqëson thelbin e funksionimit të fabrikës dhe siguron që të gjitha aktivitetet të kryhen në mënyrë të qëndrueshme dhe efikase, duke respektuar standardet mjedisore dhe sociale.

d) Përshkrimi detaj i procesit teknologjik

Prodhimi i gëlqeres, llaçeve, ngjyrave dhe materialeve izoluese është një proces i përpiktë dhe kompleks që përfshin disa hapa të avancuar, duke kërkuar përdorimin e teknologjive moderne dhe njohurive të thella shkencore dhe inxhinierike. Secili nga këto produkte ka një rol të veçantë në industrinë e ndërtimit, duke kontribuar në stabilitetin, estetikën dhe efikasitetin

energjetik të objekteve. Ky proces kërkon monitorim dhe menaxhim të vazhdueshëm të cilësisë për të siguruar që produktet përmbushin standardet dhe kërkesat e tregut.

1. Prodhimi i Gëlqeres

Guri gëlqeror i përdorur në këtë proces ka një granulacion që varion nga 0-30 mm, në përputhje me kërkesat e produktit që do të prodhohet. Guri hidhet në bunker dhe, pas një kontrolli të cilësisë dhe pastërtisë, shpërndahet përmes një shiriti transportues për në linjat përkatëse. Pas shqyrtimit të cilësisë, materiali transferohet në një mulli bluarje që rrotullohet me shpejtësi të ndryshueshme, duke copëtuar gurin në granula të ndryshme. Kjo bëhet për të arritur granulacionin e kërkuar për produktin përfundimtar. Mulliri funksionon me një shpejtësi prej 1620 rrot/min, që mund të ndryshojë në varësi të procesit. Pas bluarjes, materiali kalon në një sistem tharjeje, ku ajri i ngrohtë ose i ftohtë përdoret për të larguar lagështinë e tepruar. Pjesa që ka mbetur (materiali i pastër) ndahet nga pluhuri që ka granulacion më të vogël se 0.9 mikron përmes një filtri të posaçëm. Ky pluhur është i mbledhur dhe përdoret përsëri në procese të tjera, duke reduktuar ndotjen dhe mbeturinat.

Materiali i pastruar dërgohet në sitat e ndarjes, ku përdoren disa grupe sitash me madhësi të ndryshme për të arritur granulacionin e kërkuar. Materiali i ndarë shpërndahet në silos të ndryshëm, ndërsa materiali që ka një granulacion më të madh se 3 mm ri-ciklohet dhe kthehet në bunker për përdorim të mëtejshëm. Duke qenë se proceset e bluarjes dhe prodhimit të llaçeve shpesh shpërndajnë pluhur, kompania ka planifikuar të instaloj sistemin thithës dhe filtrimit për të kapur këtë pluhur dhe për të mbajtur ambientin të pastër. Kjo ndihmon në ripërdorimin e pluhurit në proceset e tjera dhe minimizon ndotjen. Për më tepër, guri gëlqeror ruhet në një objekt të mbuluar për të parandaluar shpërndarjen e pluhurit, sidomos gjatë ditëve me erë. I gjithë procesi do të kryhet brenda një objekti të mbyllur, duke siguruar që nuk ka ndikime të dëmshme për mjedisin përreth. Ky qarkullim i materialeve brenda sistemit të mbyllur i mundëson kompanisë të ruajë një balancë mes prodhimit dhe mbrojtjes së ambientit.

2. Prodhimi i Llaçeve

Procesi teknologjik në këtë linjë prodhimi fillon me marrjen e materialeve nga siloset, ku ato janë të magazinuara, dhe kalojnë nëpërmjet një serie hapash të automatizuar për t'u përgatitur dhe paketuar. Pas dhënies së recepturës përkatëse nga pulti i komandimit, materiali përkatës merret nga siloset dhe futet në peshoret elektronike për peshim të saktë, sipas sasisë së kërkuar nga receta. Pas peshimit, materiali i saktë dërgohet në pjesën e miklimit (për zirje), ku realizohet përzierja e tij përkohësisht, në përputhje me kërkesat e produktit përfundimtar. Pas përfundimit të miklimit, materiali i përgatitur lirohet në një depozitë poshtë mikserit dhe, në

mënyrë automatike, fillon përgatitja për sasinë tjetër të materialit që duhet të përpunohet. Materiali i mikluar që ndodhet në depozitë poshtë mikserit mund të dërgohet në siloset përkatëse për magazinim të mëtejshëm përmes një sistemi transportues dhe elevatori, në varësi të kërkesës. Ky material mund të dërgohet gjithashtu për paketim, nëse është i gatshëm për këtë fazë të procesit. Pjesa tjetër e linjës prodhuese përfshin pajisjen mbushëse për thasët, e cila përbëhet nga gjashtë gryka mbushëse të pavarura. Çdo grykë ka një peshore elektronike të saj, dhe pas marrjes së thasëve bosh, mbushja e tyre realizohet automatikisht, në përputhje me peshën e përcaktuar. Pasi thesi është mbushur, ai kalon përmes një transportuesi dhe peshoreje të dytë që kontrollon dhe verifikon peshën e saktë të thasëve. Nëse pesha është e saktë, thesi kalon në procesin e paketimit për t’u grumbulluar në paleta. Në rastet kur pesha e materialit në thasë është jo në përputhje me parametrat, thesi i paketuara do të hiqet dhe do të dërgohet për rishikim dhe ripërdorim. Në këtë rast, materialet e papërputhura ri-integrohen në procesin e prodhimit për t’u shfrytëzuar sërish. Ambalazhi i dëmtuar grumbullohet në kontejnerë të veçantë dhe dërgohet për riciklim në ndërmarrjet që merren me riciklimin e materialeve të letrës. Në mënyrë të ngjashme, paletat e drurit, të cilat janë të kushtueshme, ripërdoren disa herë deri sa ato të dëmtohen fizikisht dhe të jenë të papërdorshme, duke u siguruar një cikël të qëndrueshëm për përdorimin e materialeve dhe uljen e mbeturinave. Ky proces i automatizuar dhe i menaxhuar me kujdes përfshin elementë të kontrolluar rigorozisht për peshën, cilësinë dhe riciklimin, duke siguruar një prodhim të qëndrueshëm dhe efikas, me një ndikim minimal në mjedis dhe optimizim të burimeve.

3. Prodhimi i Ngjyrave

Prodhimi i ngjyrave fillon me mbushjen e silosëve me lëndën e parë në formë pluhuri, një proces i cili realizohet nga një kompani e kontraktuar për furnizimin e këtyre materialeve. Pjesa tjetër e lëndës së parë, që është në formë lëngu, ruhet në depo, së bashku me një sasi të vogël pluhuri. Në procesin e prodhimit, të gjitha lëndët e para, si ato të pluhurta dhe ato të lëngshme, derdhen në kazanin e lidhur me një mikser, ku ndodhin proceset e përzierjes. Materialet lëngshme derdhen manualisht nga punëtorët, ndërsa pluhurat, që gjenden në silos, derdhen automatikisht në mikser për të siguruar një përzierje të barabartë dhe të plotë të lëndëve. Procesin e përzierjes zgjat nga 45 deri në 50 minuta, varësisht nga pesha specifike e ngjyrës që po përpunohet. Pas përfundimit të përzierjes, ngjyra e gatshme transferohet në kovë, një proces që gjithashtu realizohet automatikisht për të siguruar saktësinë dhe efikasitetin e mbushjes. Pasi kovë mbushet me ngjyrën përkatëse, ajo mbyllet manualisht me kapak nga punëtorët, duke

garantuar një mbyllje të sigurt dhe të saktë. Kovët e mbyllura pastaj vendosen në paleta, dhe produktet përfundimtare janë të gatshme për shpërndarje dhe shitje.




Figura 5. Makina për prodhimin e ngjyrave

4. Prodhimi i Materialeve Izoluese

Materialet izoluese janë të rëndësishme për mbrojtjen e ndërtesave dhe strukturave ndaj humbjeve të energjisë dhe ndikimeve të jashtme, si nxehtësia dhe zëri. Ato përdoren gjerësisht në industrinë e ndërtimit për të përmirësuar efikasitetin energjetik dhe për të krijuar kushte të kënaqshme të brendshme. Materialet për prodhimin e materialeve izoluese janë zakonisht fibra qelqi, polistiren, poliuretan dhe materialet termike të tjerë. Lëndët e para duhet të shkrijnë dhe përpunohen për të krijuar forma të përshtatshme që do të përdoren si materiale izoluese. Pas shkrirjes, lëndët e para kalojnë përmes një procesi të quajtur ekstrudim, ku materialet e shkrira kalojnë nëpër një formë për të krijuar forma të ndryshme (si pllaka ose shirita). Ky proces siguron formësimin e materialeve që mund të përdoren për izolim termik dhe akustik. Materialet izoluese duhet të kalojnë përmes një procesi të testimit për të siguruar efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e tyre gjatë përdorimit. Testimi i tyre është i rëndësishëm për të siguruar që ato ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme ndaj humbjeve të energjisë dhe ndikimeve të jashtme. Pas përfundimit të procesit të prodhimit dhe testimit, materialet izoluese pakëtohen dhe shpërndahen për përdorim në ndërtim dhe industri të tjera.




Figura 6.Scema e Procesit teknologjik

e) **Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjate fazës së operimit**

Gjatë fazës së operimit të fabrikës për prodhimin e gëlqeres, priten disa lloje mbetjesh dhe emetimesh që përfshijnë mbetje të ngurta, të lëngëta dhe emetime të gazta. Për të siguruar menaxhim të qëndrueshëm dhe minimizim të ndikimeve mjedisore, përlllogaritja bazohet në të dhëna teknologjike dhe parametrat e procesit të prodhimit.

1. Mbetjet e ngurta

- **Mbetje të gurit të papërdorur:** Pritet një përqindje e vogël e materialit të nxjerrë nga guroret të jetë jo i përshtatshëm për kalçinim, si pasojë e përmbajtjes së lartë të papastërtive. Kjo mund të përbëjë 2-5% të lëndës së parë.
- **Hiri ose pluhuri nga procesi i kalçinimit:** Gjatë kalçinimit dhe trajtimit të materialeve, krijohen pluhura që filtrohen përmes sistemeve të kapjes së grimcave dhe mund të arrijnë rreth 1-3% të prodhimit total.

2. Mbetjet e lëngëta

- **Ujë i përdorur për ftohje:** Në rastin e përdorimit të sistemeve të ftohjes me ujë të qarkullimit të mbyllur, sasia e mbetjeve ujore është minimale. Nëse përdoret sistem i hapur, humbjet për shkak të avullimit dhe mbetjet nga pastrimi i pajisjeve mund të përbëjnë deri në 0.5-1% të ujit të përdorur.

3. Emetimet e gazta

- **Dioksidi i karbonit (CO₂):** Ky është emetimi kryesor që prodhohet gjatë shpërbërjes termike të karbonatit të kalciumit në oksid kalciumi. Për çdo ton gëlqereje të prodhuar, pritet lëshimi i afërsisht 0.78 ton CO₂.
- **Pluhuri i emetuar në atmosferë:** Edhe pas përdorimit të filtrave, pritet që rreth 0.01-0.03% e materialit të grimcuar të lëshohet në formë pluhuri.
- **Gazra ndihmës:** Procesi i djegies së karburanteve për prodhimin e nxehtësisë mund të shkaktojë emetim të gazeve si oksidet e azotit (NO_x), oksidet e squfurit (SO_x) dhe komponime organike të paqëndrueshme (VOC), në sasi që varen nga cilësia e karburantit të përdorur.

Për të minimizuar ndikimin në mjedis, do të përdoren sisteme moderne filtrimi dhe riciklimi për pluhurat dhe mbetjet e ngurta. Emisionet e CO₂ dhe gazrave të tjerë do të kontrollohen përmes teknologjive të djegies efikase dhe reduktimit të emetimeve. Uji i përdorur do të trajtohet në impiante të specializuara përpara rikthimit ose largimit. Këto masa jo vetëm që reduktojnë ndikimin mjedisor, por gjithashtu rrisin efikasitetin operacional të fabrikës dhe përputhshmërinë me standardet mjedisore.

4. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME

Gjatë procesit të zgjedhjes së lokacionit për ndërtimin e fabrikës nga “DP & PARTNERS” SH.P.K., është realizuar një analizë e detajuar e alternativave të ndryshme për të siguruar që kompania të mund të zhvillohet dhe të mbetet e qëndrueshme në afatgjatë. Ky proces ka shqyrtuar disa faktorë kyç që ndikojnë në zgjedhjen e një lokacioni optimal për fabrikën, duke u fokusuar në nevojat e kompanisë dhe mundësitë që ofrohen nga secili lokacion. Disa nga alternativat kryesore që janë shqyrtuar janë:

– Zgjedhja e Zonave Industriale të Përshtatshme

Një nga alternativat e para ishte zgjedhja e një lokacioni brenda zonave industriale që janë tashmë të zhvilluara dhe të pajisura me infrastrukturë moderne, si rrugë të mirëfillta, linja energjetike, ujësjellës dhe kanalizime. Kjo mundësi do të mundësonte përdorimin e mundësive ekzistuese infrastrukturore dhe do të reduktonte ndjeshëm investimet fillestare.

– Lokacionet Afër Rrugëve Kryesore dhe Linjave të Transportit

Një mundësi tjetër ishte zgjedhja e një lokacioni që është afër rrugëve kryesore, autostradave, ose hekurudhave, duke siguruar kështu mundësi të shpejta dhe të lirë për transportimin e produkteve dhe lëndëve të para.

– **Afërsia me Burime të Lëndëve të Para**

Një tjetër alternativë është zgjedhja e një lokacioni që ka afër burime natyrore dhe lëndë të para të nevojshme për prodhimin . Zgjedhja e një lokacioni të tillë mund të sjellë ulje të kostove dhe siguri në furnizim me materialet e nevojshme.

– **Disponibiliteti i Fuqisë Punëtore të Kualifikuar**

Një faktor tjetër i rëndësishëm në zgjedhjen e lokacionit është mundësia e gjetjes së fuqisë punëtore të kualifikuar dhe me kosto më të ulëta në krahasim me qytetet më të mëdha. Kjo mund të ndihmojë në uljen e kostove operative dhe në rritjen e efikasitetit të prodhimit.

– **Zonat me Mundësi për Zhvillim Afatgjatë**

Një tjetër mundësi e shqyrtuar ishte zgjedhja e një lokacioni që ofron mundësi për zgjerim dhe zhvillim afatgjatë. Ky opsion është i rëndësishëm për të siguruar fleksibilitet në rast se kërkesa për produkte rritet dhe nevojitet një rritje e kapaciteteve prodhuese.

– **Mbështetje e Administratës Lokale dhe Lehtësira Fiskale**

Një faktor i rëndësishëm ishte mbështetja nga autoritetet lokale për investitorët dhe zhvillimin e industrisë. Lokacionet që ofrojnë lehtësira fiskale dhe mbështetje në aspektin administrativ janë tërheqëse për investitorët që kërkojnë të zvogëlojnë kostot e fillimit të operacioneve.

5. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT

Gjendja aktuale në Komunën e Lipjanit karakterizohet nga një përzierje sfidash dhe mundësish. Një nga çështjet kryesore është zhvillimi ekonomik, i cili po shfaqet në rritje përmes investimeve në industri dhe bujqësi. Megjithatë, janë të pranishme edhe probleme mjedisore, si ndotja e ajrit dhe menaxhimi i mbetjeve. Infrastruktura e transportit po përmirësohet, por ende ka nevojë për modernizim të mëtejshëm. Popullsia e Komunës së Lipjanit është diversifikuar, me një numër të madh të rinjve që kërkojnë mundësi pune. Mjedis natyror ka nevojë për mbrojtje dhe rehabilitim, veçanërisht pas ndotjes nga aktivitetet industriale dhe urbanizimi. Aktivitetet për pastrimin e zonave dhe mbjelljen e bimëve vendase janë të rëndësishme për rikthimin e biodiversitetit. Për më tepër, ka nevojë për rritje të ndërgjegjësimit për çështjet mjedisore dhe përfshirje të komunitetit në projekte që promovojnë mbrojtjen e mjedisit. Komuna e Lipjanit ka potencial të madh për zhvillim të qëndrueshëm, nëse adresohen këto sfida.

5.1 Hidrografia

Në aspektin hidrografik ujërat në Komunën e Lipjanit i takojnë pellgut të Detit të Zi, ndërsa lumenjtë më të mëdhenj janë lum i Sitnica dhe Drenica të cilët janë edhe nën degë të lumit Ibër.

Në përgjithësi rrjeti hidrografik është i pasur dhe me potencial ujorë të varfër, i kushtëzuar nga sasia e vogël e reshjeve mesatare shumëvjeçare (600mm). Lumi Sitnica është lumi më i madh nëkomunë e Lipjanit i cili degët më të zhvilluara i ka në anën lindore, ndërsa degët kryesore hidrografike të anës lindore janë: Lumi Janjevka, Lumi i Zhegovcit, Lumi i Gadimës dhe Lumi i Sazlisë ndërsa, në anën perëndimore lumi më i zhvilluar është Lumi i Vërshevcit. Sasitë më të mëdha të reshurave janë gjatë muajit prill dhe maj, prandaj periudha pranverore është ajo kur paraqiten vërshimet dhe kur kemi edhe paraqitjen e kënetave, posaçërisht në tokat të cilat nuk e lëshojnë ujin në lidhje me ndërtimin e hidrocentralit të Zhurit. Këto hulumtime janë ende në vazhdim dhe janë në pritje të finalizimit të projektit dhe fillimin e punimeve.




Figura 7. Harta Hidrojeologjike

5.2 Ndotësit Kryesorë

Ndotësit kryesorë në Komunën e Lipjanit përbëjnë një shqetësim të rëndësishëm për mjedisin dhe shëndetin e popullsisë, duke rezultuar nga aktivitete industriale, urbanizimi dhe bujqësia. Ndotja e ajrit është një nga problemet kryesore, e cila vjen si pasojë e emisioneve nga industria, transporti dhe ndërtimi. Gazrat si dioksidi i karbonit (CO₂), oksidet e azotit (NO_x) dhe grimcat e pluhurit (PM₁₀ dhe PM_{2.5}) janë të pranishme në nivele që mund të ndikojnë negativisht në shëndetin e qytetarëve dhe cilësinë e ajrit. Ndotja e ujit gjithashtu është një shqetësim, ku aktivitetet bujqësore sjellin shkarkime të pesticideve dhe plehrave kimikë në lumenj dhe

burime të ujit, ndërsa derdhjet e ujërave të ndotura nga industria dhe menaxhimi i pamjaftueshëm i mbetjeve kontribuojnë në këtë problem. Ndotja e tokës është një tjetër aspekt, me shkarkimin e mbetjeve të ngurta dhe kimikëve që ndikon në cilësinë e tokës dhe biodiversitetin. Ndërsa ndotja akustike, për shkak të zhurmave nga trafiku dhe aktivitetet industriale, ndikon në cilësinë e jetës dhe shëndetin mendor të banorëve. Menaxhimi i dobët i mbetjeve, që çon në akumulimin e tyre në vende të hapura, krijon probleme për ambientin dhe shëndetin publik. Këto ndotës kërkojnë vëmendje të madhe dhe masa të menjëhershme për të minimizuar ndikimin e tyre, duke theksuar rëndësinë e një qasjeje të integruar për menaxhimin e ndotjes, përfshirë monitorimin dhe implementimin e politikave mjedisore

5.3 Flora dhe Fauna

Flora dhe fauna në Komunën e Lipjanit paraqesin një ekosistem të pasur dhe kompleks, i cili është rezultat i një kombinimi të faktorëve gjeografikë, klimaterikë dhe ekologjikë. Ky rajon karakterizohet nga morfologji të ndryshme, përfshirë kodra dhe fusha, që krijon kushte të favorshme për zhvillimin e një biodiversiteti të larmishëm. Flora e Komunës së Lipjanit është e pasur me një larmi bimësh, duke përfshirë pyje të ndryshme të përbërë kryesisht nga pemë si Dushku, lis dhe pisha. Këto lloje janë thelbësore për ruajtjen e ekosistemeve lokale, pasi ato ofrojnë habitat për shumë specie të kafshëve dhe kontribuojnë në mbrojtjen e tokave nga erozioni. Në lëndinat dhe hapësirat e hapura, gjenden një gamë e gjerë bimësh herbacee dhe lulesh, të cilat janë të rëndësishme për ekosistemet dhe ofrojnë burime ushqimi për shumë speciet e faunës. Fauna e këtij rajoni është po ashtu shumë e diversifikuar. Në pyjet e Komunës jetojnë specie si dhitë e egra dhe derrat e egër, ndërsa në hapësira të tjera mund të gjenden kafshë si lepuj dhe qen të egër. Shpendët përbëjnë një tjetër komponent të rëndësishëm të biodiversitetit, duke përfshirë zogj migrues dhe shpendë endemikë, të cilët janë të rëndësishëm për pollinimin dhe përhapjen e farave. Megjithatë, flora dhe fauna e Komunës së Lipjanit përballen me disa sfida, përfshirë ndotjen e mjedisit dhe shkatërrimin e habitateve natyrore për shkak të urbanizimit dhe aktiviteteve industriale. Këto faktorë kanë pasur ndikim negativ në biodiversitet, duke rritur rrezikun për shumë specie.




Figura 8. Harta e mjedisit pyjor

5.4 Transporti dhe infrastruktura

Transporti është një ndër komponentët kyç për përmbushjen e kërkesave për lëvizje ditore. Është faktor përmbajtësor për zhvillim ekonomik, social e mjedisor, si dhe luan rol të rëndësishëm në relacionet hapësinore ndërmjet hapësirave dhe destinimeve të tyre. Infrastruktura e transportit duhet të përballojnë kërkesat e vazhdueshme për sa i përket kërkesës për transport, tendencave të reja, presioneve shoqërore dhe efikasitetit të buxhetit. Lipjani është i pozicionuar në udhëkryqin në mes të dy rrugëve të rëndësishme nacionale dhe evropiane N 25 (E 752) dhe N2 (E 65), ndërsa hekurudha kryesore Mitrovicë/Fushë Kosovë dhe Ferizaj/Shkup e cila kalon në mes të Lipjanit me stacionin e pasagjerëve dhe trafikut tëmallrave, e lidhë Kosovën me korridorin e Hekurudhor panevropian. Ky pozicion gjeografik i ofron Komunës së Lipjanit mundësi të volitshme të shfrytëzimit të trafikut rrugor-hekurudhor dhe ajror, për shkak se Aeroporti i vetëm ndërkombëtar ndodhet në Komunën e Lipjanit dhe është nga qendra vetëm 15 km. Komuna e Lipjanit karakterizohet me tri lloje të transportit atë rrugor, hekurudhor dhe atë ajror. Infrastruktura e transportit në komunën e Lipjanit shtrihet në një gjatësi prej 433.3 km, e cila gjatësi përbëhet nga infrastruktura rrugore me gjatësi prej 412 km (ose 95%), infrastruktura hekurudhore me një gjatësi prej 8.9 km (ose 2%) dhe infrastruktura ajrore me një gjatësi prej 11.4 km (ose 3%). Në komunë e Lipjanit për nga karakteri ekzistojnë katër nivele të rrugëve, duke filluar nga autoudha, rrugët nacionale,

rajonale dhe ato lokale. Në përputhje me Ligjin, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) është përgjegjëse për menaxhim, ndërtim, rindërtim, mirëmbajtje dhe mbrojtje të autoudhëve, rrugëve nacionale dhe rrugëve rajonale. Ndërsa, Komuna e Lipjanit është përgjegjëse për rrjetin rrugor lokal.




Figura 9. Infrastruktura rrugore

5.5 Mbeturinat e ngurta

Mbeturinat komunale përmbajnë një game të gjerë të ndotësve, përfshirë metalet e rënda, cianidin (CN), Hidrokarburet policiklike, bifenilet e polikloruara, azbestin, metanin, amoniakun dhe hidrogjen sulfidet të cilat kanosin tokat përreth. Klasifikimi i mbeturinave bëhet sipas Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina dhe ndahen në mbeturina komunale, komerciale, industriale dhe medicinale. Ndërsa sipas nivelit të rrezikshmërisë ndahen në mbeturina Inerte, të parrezikshme, dhe të rrezikshme. Një gjenerim mesatar i mbeturinave në nivel komune për kokë banori është siguruar nga baza e të dhënave nga operatori K.R.M “Pastrimi”, dhe planet komunale. Operatori përcakton sasinë përmes peshimit të mbeturinave të përziara komunale, nga ku rezulton 13,033 ton/vit mbeturina të gjeruara në komunën e Lipjanit, 56,673 banorë të shërbyer, gjenerimi për kokë banori rezulton 229.9 kg/banorë/vit. Shifra mbi gjenerimin e mbetjeve për vit është marrë për të tre kategoritë e klientëve, duke qenë se operatori nuk aplikon gjenerimin ndaras sipas kategorive.

6. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Investimi në fabrikën për prodhimin e gëlqeres, llaçnave, ngjyrave dhe materialeve izoluese paraqet një kontribut mjaft të vlefshëm për produkte që do të ofroj si dhe për mundësitë e punësimit. Ndikimet në mjedis janë shume minimale mos të themi fare nuk kanë ndikim në mjedis, vetëm se në shkallë të caktuara duke filluar nga minimumi real i këtij ndikimi. Duke u bazuar në analizën e ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqesim në këtë rast një analizë më të hollësishme të ndikimeve të mundshme në mjedis duke specifikuar edhe masat zbutëse që do të përdoren për të eliminuar apo për të i minimizuar këto ndikime. Gjatë punës kontinuele të fabrikës së prodhimit e gëlqeres, llaçnave, ngjyrave dhe materialeve izoluese vjen deri te rritja e emisionit të materieve ndotëse nga lëvizja e makinave derdhjet eventuale të lëndës së parë apo produktit final, krijohet zhurmë nga lëvizjet e makinave në rrugën në afërsi të fabrikës. Analiza e VNM-së në këtë rast realizohet duke u bazuar në projektin e projektuar për tu ndërtuar, më lart në këtë raport si dhe nga gjendja reale në lokacionin respektivisht zonën ku pritet te ndërtohet objekti të cilin e ka planifikuar kompania “DP & PARTNERS” SH.P.K. Kjo analizë kryhet me qëllim të vlerësimit të ndikimit në mjedis në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit duke mos i cenuar aspektet: kimike-fizike (ndikimet në burimet natyrore dhe degradimi fizik i mjedisit), biologjike-ekologjike (ruajtja e biodiversitetit, ndikimi mbi jetën e gjallë dhe biosferë) dhe socio-ekonomike (ndikimet e përkohshme apo të përhershme pozitive apo negative).

6.1 Ndikimet në ajër

